

PAULO COELHO

ALKIMISTI

ROMAN

BOTIMET TOENA

PAULO COELHO

ALKIMISTI

roman

Përktheu
Nonda Varfi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Titulli në origjinal: *O Alquimista*

Titulli në frëngjisht: *L'Alchimiste*

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me

Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona-Spain.

www.santjordi-asociados.com

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e kopertinës: Jim Tierney, në bashkëpunim me HarperCollins,
me bazë në Nju-Jork, SHBA.

ISBN 978-9928-348-74-6

© Paulo Coelho, 1988

<http://paulocoelhoblog.com>

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi
me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me
shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Oh, Marie e ngjizur pa mëkatuar,
lutu për ne që përgjrohemi për Ty!
Amen.

AJ.

Alkimistit që njih dhe përdor
të fshehtat e Veprës së Madhe.

Vlerësime për romanin “Alkimisti”

*‘Alkimisti’ ishte dashuria ime e parë letrare.
Libri i foli shpirtit tim. Nuk e lëshova nga dora për një kohë.
Ai depërtoi tek unë dhe transformoi mënyrën time të këndvështrimit
dhe të vetekzistencës.*

*‘Alkimisti’ është ndoshta libri më me ndikim,
që unë kam lexuar ndonjëherë.
E ndriçoi shpirtin tim prej ëndërrimtari dhe i dha kuptim vuajtjes sime.
Ashtu si Santiago vuajti dhe mbijetoi
në kërkim të thesarit të vet, atëherë edhe unë mund ta bëj.”*

~ Will Smith

*“Historia e këtij libri ka sharmin komik, tensionin dramatik
dhe intensitetin psikologjik të një përralle, por është gjithashtu
e mbushur me urrezi të veçantë... Një tregim i ëmbël ekzotik
si për të rinjtë, ashtu edhe për të moshuarit.”*

~ Publishers Weekly

*“Brenda kësaj historie bindëse dhe elegancës vezulluese me të cilën
tregohet, qëndron në thelb urrezia për dëgjimin e zemrës.”*

~ Booklist

*“Po aq i paharrueshëm dhe kuptimplotë
si ‘Princi i vogël’ i Saint-Exupéry.”*

~ Austin American-Statesman

“Një fabul prekëse, frymëzuese.”

~ Indianapolis Star

“Një shpim i vogël në brinjë nga dikush lart.”

~ Detroit Free Press

“Alkimisti’ është një sukses i jashtëzakonshëm.”

~ Der Spiegel (Gjermani).

"Një përrallë e jashtëzakonshme rreth udhëtimit më magjik
të të gjitha llojeve të udhëtimeve:
atij të kërkimit për të pëmbushur fatin e dikujt.
Ja rekomandoj 'Alkimisti'-n çdokujt që është në ndjekje
të ëndrrave të tij."

~ **Anthony Robbins**, autor i *Awaken the giant within*.

"Një rrëfim ambicioz mbi mençurinë universale
nëpërmjet të cilës mund të ndërtojmë çështjet e jetëve tona."

~ **Spencer Johnson**, autor i *Who moved my cheese*.

"Një tregim aventuresk i mbushur plot me magji dhe urtësi."

~ **Rudolfo Anaya**, autor i *Bless me, Ultima*.

"'Alkimisti' është një libër i bukur rreth magjisë, ëndrrave
dhe thesareve që ne kërkojmë diku tjetër dhe që më pas
i gjejmë në pragun tonë."

~ **Madonna** në *Sonntag Aktuell* (Gjermani).

"'Alkimisti' është një kënaqësi e pandërprerë dhe mrekulli frymëzuese.
Kjo fabul është një amalgamë e trëndafilltë e kërkimit shpirtëror,
enigmës ekzistenciale, ndjeshmërisë së mrekullueshme
dhe fuqisë së brendshme."

~ **Malcolm Boyd**, autor i *Are you running with me Jesus?*

"Paulo Coelho e njuh mirë sekretin e alkimisë letrare."

~ **Kenzaburo Oé**, fitues i Çmimit Nobel në Letërsi.

"'Alkimisti' është, me të vërtetë, një libër poetik."

~ **Welt am Sonntag** (Gjermani).

"Tregimi më i ëmbël dhe i ndjeshëm. Është një libër i rrallë dhe me siguri do të prekë çdo zemër, që kërkon fatin e saj në udhëtimin e jetës."

~ **Gerald G. Jampolsky**, bashkautor i *Change your mind* dhe *Love is letting go of fear*.

"Rrallë më rastis të has në një histori kaq të drejtpërdrejtë dhe të thjeshtë sa 'Alkimisti' i Coelho-s.

E nxjerr lexuesin nga koha aktuale dhe përqendrohet në historinë e një ëndërrimtari të ri që është në kërkim të vetes.

Një vepër e bukur me mesazhe të forta për lexuesit."

~ **Joseph Girzone**, autor i *Joshua*.

"Ky është lloji i librit që të bën të kuptosh më shumë rreth vetes dhe jetës.

Ka filozofi dhe është i spërkatur me ngjyra, shije dhe tema, si një përrallë.

Një libër i mrekullueshëm."

~ **Yedi'ot Aharonot** (Izrael).

"Misteri në aventurat e çuditshme të Santiagos, mund të të sjellë më afër njohjes dhe arritjes së vetë fatit tënd."

~ **Charlotte Zolotow**, autore e *If you listen*.

"Paulo Coelho të jep frymëzimin për të ndjekur ëndrrat e tua, duke parë botën nëpërmjet syve të tu dhe jo të dikujt tjetri."

~ **Lynn Andrews**, autore e *Medicine Woman series*.

"Asgjë nuk është e pamundur për sa kohë e dëshiron atë me gjithë shpirt' - i tillë është mesazhi i Coelho-s. Asnjë libër tjetër nuk përmban kaq shumë shpresë dhe mrekulli. Autori i tij është si një guru midis të gjithë atyre që janë në kërkim të kuptimit të jetës."

~ **Focus** (Gjermani).

"Stili poetik, metaforat dhe depërtimet e thella në libër,
trazojnë mendjen tonë dhe na çojnë në një udhëtim fantastik të shpirtit."

~ **Yomiuri Shimbun** (Japoni).

"'Alkimisti' të sjell në mendje 'Princin e vogël' nga Saint-Exupéry
dhe 'Profetin' nga Khalil Gibran, po ashtu edhe shëmbëlltira biblike."

~ **Gazeta "Wyborcza"** (Poloni).

"'Alkimisti' është një histori e bukur dhe që të ngroh shpirtin me një
shije ekzotike... Mund ose mund të mos biesh dakord me filozofinë e

Paulo Coelho-s, por gjithsesi është një përrallë
që na ngushëllon zemrat tona, po aq sa shpirtrat tanë."

~ **Bergensavisen** (Norvegji).

"'Alkimisti' është si 'Princi i vogël' i ditëve moderne.

Një libër suprem dhe i thjeshtë."

~ **Milorad Pavic**, autor i *Dictionary of the Khazars*.

"Midis shkrimtarëve të Amerikës Latine, vetëm Gabriel Garcia
Marquez është më i lexuar se Paulo Coelho i Brazilit."

~ **Gazeta "The Economist"** (Mbretëria e Bashkuar).

"Një djalë i quajtur Santiago bashkohet me radhët e *Candides* dhe
Pinokut, duke na çuar në një aventurë të shkëlqyer."

~ **Paul Zindel**, fitues i Çmimit Pulitzer me dramën
The effect of Gamma rays on Man-in-the-Moon marigolds.

Në rrugë e sipër ata hynë në një qytezë. Dhe një grua me emrin Marta i priti në shtëpinë e saj.

Ajo kishte një motër me emrin Mari, që ra në gjunjë te këmbët e Jezusit dhe mbajti vesh mësimet e tij.

Marta që shkonte e vinte nga të gjitha anët, e zënë me shumë punë, iu qas Jezusit dhe i tha:

- Imzot! A nuk të duket vallë se ime motër m'i lë mua të gjitha punët? Thuaji pra të vijë të më ndihë.

Dhe Jezusi iu përgjigj:

- Martë! Martë! Ti po brengosesh dhe po shqetësohesh për shumë gjëra. Maria, për vete, bëri zgjedhjen më të mirë, dhe kjo nuk do t'i merret.

Lluka, X, 38-42

PARATHËNIE

Është e rëndësishme të thuhet, paraprakisht, që *Alkimisti* është një libër simbolik, ndryshe nga romani *Pelegrini i Kompostelës*, i cili është një punë përshkrimore.

E kam studiuar alkiminë përgjatë 11 viteve të jetës sime. Edhe vetëm ideja e thjeshtë, për të transformuar metalet në ar apo për të zbuluar Eliksinin e jetëgjatësisë, është më se joshëse për të tërhequr cilindo magjistar fillestar. Duhet të pohoj se ai çka më tundonte më shumë ishte Eliksiiri i jetëgjatësisë, sepse para se të kuptoja dhe të ndieja praninë e Zotit, mendimi që një ditë gjithçka do të mbaronte më dëshpëronte. Ndaj, kur mësova se ishte e mundur të përfitohej një lëng, i aftë të zgjaste për shumë vite jetën time, vendosa t'i përkushtohesha me mish e shpirt fabrikimit të tij.

Ishte periudha e shndërrimeve të mëdha sociale (fillimi i viteve '60-të) dhe në Brazil nuk gjendeshin botime serioze mbi alkiminë. Ashtu si dhe personazhi i librit, fillova t'i shpenzoja ato pak para që kisha për blerjen e librave të importuar dhe kaloja çdo ditë orë pa fund duke studiuar simbolikën e tyre të komplikuar. U mundova të lidhesha me nja dy persona në Rio-de-Zhanejro që i ishin përkushtuar seriozisht Veprës së Madhe, por ata refuzuan të më takonin. Njoha edhe të tjerë që e mbanin veten për

alkimistë, që kishin laboratorë dhe më premtorin se do të më mësonin sekretet e Artit në shkëmbim të pasurive të vërteta; sot e kuptoj që, në realitet, ata nuk dinin asgjë lidhur me ato çka pretendonin se do të më mësonin.

Pavarësisht përpjekjeve të mia, rezultatet ishin praktikisht nul. Asgjë nuk prodhohej sipas asaj që pohonin manualet e alkimisë me gjuhën e tyre të errët. Kishte një pafundësi simbolesh, dragonj, luanë, diell, hëna dhe mërkurë, dhe vazhdimisht kisha përshtypjen se isha në rrugë të gabuar, sepse gjuha simbolike ka një marzh gabimi gjigant. Në vitin 1973, i shkura juar nga mungesa e progresit tim, bëra një gabim të madh. Në atë kohë, isha ngarkuar nga Sekretariati i Edukimit të Mato Grosso-s, për të bërë kurse teatri në atë shtet, dhe vendosa të përdorja nxënësit e mi të kursit të teatrit, tema e të cilit ishte “Tavolina e Smeraldit”. Ky qëndrim, bashkë me disa inkursione në zonat moçalore të Magie-s pati si pasojë aplikimin ndaj meje të fjalës së urtë: “Kush thyen, paguan”. Gjithçka rreth meje u shemb plotësisht.

I kalova gjashtë vitet e mëpasshme të jetës sime në një lloj skepticizmi ndaj gjithçkaje që kishte lidhje me mistiken. Në këtë syrgjynosje shpirtërore, mësova shumë gjëra të rëndësishme: ne pranojmë një të vërtetë vetëm kur, paraprakisht, e kemi mohuar nga fundi i shpirtit tonë; ne nuk duhet t’i ikim fatit tonë; dhe dora e Zotit është pafundësisht bujare, në raport me rreptësinë e Tij.

Më 1981, takova RAM-in, Mjeshtrin që më ktheu në rrugën e hapur nga unë. Duke ndjekur mësimet e tij, fillova të studioja sërish lidhur me alkiminë për llogarinë time. Një mbrëmje, kur ishim duke folur pas një seance rraskapitëse mbi telepatinë, e pyeta përse gjuha e alkimistëve ishte aq e paqartë dhe e komplikuar.

- Ka tre tipa alkimistësh, - më tha Mjeshtri im. Ata që janë të pasaktë, sepse nuk dinë për çfarë flasin; ata që dinë për çfarë flasin, por nuk e dinë që gjuha e alkimisë i drejtohet zemrës dhe jo arsyes.

- Po tipi i tretë? - e pyeta.

- Ata që nuk kanë dëgjuar kurrë të flitet për alkiminë, por që arrijnë përmes jetëve të tyre, të zbulojnë Gurin Filozofik.

Në këtë mënyrë, Mjeshtri im, që i përkiste grupit të dytë, vendosi të më jepte kurse alkimie. Atëherë, zbulova se gjuha simbolike, që më irritonte dhe më çorientonte, ishte e vetmja mënyrë për të arritur Shpirtin e Botës, apo atë që Jung e quan “inkoshencë kolektive”. Zbulova Legjendën Personale dhe Shenjat e Zotit, të vërteta që arsyetimi im intelektual refuzonte t’i pranonte për shkak të thjeshtësisë së tyre. Zbulova se arritja te Vepra e Madhe nuk është e rezervuar vetëm për një elitë të vogël, por për të gjitha qeniet njerëzore mbi Tokë. Është evidente se Vepra e Madhe nuk paraqitet gjithmonë në formën e një veze apo të një lëngu në një flakon, por ne mundemi të gjithë - pa asnjë dyshim - të zhytemi në Shpirtin e Botës.

Ja përse Alkimisti është gjithashtu një vepër simbolike. Përgjatë faqeve, përveç transmetimit të gjithçkaje që kam mësuar lidhur me këtë temë, ia kam dalë të nderoj edhe shkrimtarët e mëdhenj që kanë arritur të prekin Gjydhën Universale: Hemingway, Blake, Borges (i cili madje ka përdorur historinë perse në një prej tregimeve të tij) dhe Malba Tahan, mes të tjerëve.

Për ta plotësuar këtë parathënie dhe për të ilustruar atë që Mjeshtri im donte të thoshte lidhur me tipin e tretë të alkimistëve, ia vlen të kujtoj një histori që ma ka treguar ai vetë në laboratorin e tij.

Virgjëresha Mari, me Fëmijën Jezu në krahë, vendosi të zbriste në Tokë dhe të vizitonte një manastir. Tejet krenarë, të gjithë priftërinjtë u vunë në rresht dhe, një nga një, i afroreshin Virgjëreshës për ta nderuar. Një deklamonte poema të bukura, tjetri tregonte krijimet që kishte realizuar për Biblën, një i tretë recitoi emrat e të gjithë shenjtorëve. Dhe kështu, me radhë, murg pas murgu, ata nderuan me adhurim Marinë dhe Fëmijën Jezu.

Në fund të rreshtit ishte një murg, më i përluri i të gjithë manastirit, i cili nuk i kishte mësuar kurrë tekstat e urta të kohës. Prindërit e tij ishin shumë të varfër, ata punonin në një cirk të vjetër të zonës, dhe gjithçka që i kishin mësuar djalit, ishte arti i zhonglerit.

Kur erdhi radha e tij, murgjit e tjerë donin t'i jepnin fund pritjes, sepse ish-zhongleri nuk kishte asgjë të rëndësishme për të thënë apo për të bërë, dhe ai mund të diskreditonte imazhin e manastirit. Por, thellë në shpirtin e tij, ai ndiente një nevojë të madhe për t'i dhënë diçka të tijën Jezuit dhe Virgjëreshës.

I turpëruar, duke ndier mbi vete të gjitha vështrimet qortuese të vëllezërve të tij, ai nxori nga torba e tij disa portokaj dhe filloi të zhonglonte me ta. Kjo ishte gjithçka që dinte të bënte.

Atëherë, Fëmija Jezu buzëqeshi dhe filloi të duartrokiste në prehrin e Marisë. Dhe Virgjëresha zgjati krahët dhe ia dha murgut të mbante pak Fëmijën.

Autori

Prolog

Alkimisti mori në dorë një libër që e kishte sjellë dikush nga karvani. Libri ishte pa kapak, por ai gjithsesi mundi të njihte autorin: Oscar Wilde. Duke e shfletuar, hasi një histori që fliste për Narcizin.

Alkimisti e njihte legjendën e Narcizit, të atij djaloshi të bukur që shkonte çdo ditë të sodiste bukurinë e tij në ujin e një liqeni dhe që ishte aq i magjepsur pas vetes, sa një ditë ra në liqen dhe u mbyt. Te vendi ku kishte rënë, mbiu një lule që u quajt Narcis.

Por Oscar Wilde nuk e mbyllte kështu historinë.

Thoshte se pas vdekjes së Narcizit, Oreadat, zanat e pyjeve, kishin shkuar buzë liqenit me ujë të ëmbël dhe kishin parë se ky ishte shndërruar në një pëllg me lot të hidhur.

- Përse qan? - pyetën Oreadat.

- Qaj për Narcizin, - u përgjigj liqeni.

- Kjo nuk na çudit aspak, - thanë ndërkohë ato. -

Ne të gjitha më kot e ndiqnim pas tërë kohën, ti ishe i vetmi që mund ta sodisje nga afër bukurinë e tij.

- A nuk ishte vërtet i bukur Narcizi? - pyeti liqeni.

- E kush më mirë se ti mund ta dinte? - ia kthyen Oreadat të habitura. - Se fundja në brigjet e tua përkulej përditë!

Liqeni qëndroi një çast pa folur. Pastaj tha:

- Qaj për Narcizin, por kurrë nuk e kisha vënë re se Narcizi ishte i bukur. Qaj për Narcizin, sepse sa herë që përkulej në brigjet e mia, mund të shikoja në thellësi të syve të tij, shëmbëlltyrën e bukurisë sime.

- Ja një histori e bukur, - tha Alkimisti.



Pjesa e parë

